

ARTIKULLI #1

USAID SJELL EKSPERTËT E UI PËR TË LIDHUR ARSIMIN E LARTË DHE SEKTORIN PRIVAT NË KOSOVË DHE IOWA

Lansimi i Partneritetit me Sektorin Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë, në Bibliotekën Kombëtare në Prishtinë, Kosovë

[APRIL 24TH, 2023]

Për më shumë foto mbi këtë artikull, shkoni në këtë

link: <https://drive.google.com/drive/u/0/folders/1hmkX04nuQfv5m32cskBF5GNtI3LKDxyW>

Më shumë se 20 profesorë, studentë dhe staf nga Universiteti i Iowa do të punojnë me kolegë të tyre në universitete në Kosovë përgjatë pesë vjetëve të ardhshme, për të forcuar lidhjet mes arsimit të lartë dhe sektorit privat, duke promovuar kështu suksesin e studentëve dhe mundësive të tyre profesionale.

Këto përpjekje janë pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit me vlerë 3.9 milionë dollarë nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) për Universitetin e Iowa, e cila është në partneritet me Universitetin e Shtetëror të Iowa dhe Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC), organizatë jofitimprurëse për trajnime arsimore, e bazuar në Prishtinë. Aktiviteti i financuar nga USAID synon të përmirësoj mënyrën se si tri universitetet publike në Kosovë ndërveprojnë me kompanitë bujqësore dhe ato të teknologjisë informative dhe të komunikimit, duke çuar drejt hulumtimeve të cilat orientohen më shumë nga industria, dhe të diplomuar të cilët janë më të përgatitur për tregun e punës.

Emërtimi zyrtar i aktivitetit të financuar nga USAID është Partneritetet e Sektorit Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë (PSPFAL).

Ekspertët e Universitetit të Iowa do të udhëheqin përpjekjet për të rritur bashkëpunimin mes Kosovës dhe shtetit të Iowa, për të shtuar mundësitë ekonomike për të rinjtë/rejat e Kosovës, duke lidhur në mënyrë të prekshme sektorin privat të Kosovës me universitetet e saj publike.



Dekani i Kolegjit për Arsim të Lartë të Universitetit të Iowa, Daniel L. Clay (i dyti nga majtas), Cassie Barnhardt, Profesoreshë e Asociuar e Arsimit të Lartë dhe Marrëdhënie për Studentë nga Kolegji i Arsimit i Universitetit të Iowa (e treta nga djathtas), dhe Russell Ganim, prorektor i asociuar dhe dekan i Programeve Ndërkombëtare i UI (i dyti nga majtas), me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti (i treti nga majtas), ambasadori i SHBA në Kosovë, Jeffrey Hovenier (mes), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arberie Nagavci (djathtas në fund), dhe Drejtori i USAID për Misionin në Kosovë, Zeinah Salah (majtas në fund). Foto nga USAID.

Cassie Barnhardt, profesoreshë e asociuar për Arsim të Lartë dhe Marrëdhënie për Studentë në Kolegjin e UI për Arsim, është hulumtuesja kryesore, e cila udhëheq projektin nga Iowa.

“Bashkëpunimi ynë do të krijoj mundësi që trupi pedagogjik dhe stafi i Universitetit të Iowa, në disiplina të ndryshme dhe njësi administrative, të ndërveproj me homologët e tyre në Kosovë përmes mentorimit, ndarjes së ideve, dhe ndërtimit të kapaciteteve”, thotë Barnhardt. “Shkëmbimi i ekspertizës, marrëdhënive, dhe qasjeve do të përmirësojnë mësimnxënien nëpër klasë, kërkimin dhe zbulimet shkencore, dhe do të nxisin forma të reja të bashkëpunimit brenda universiteteve tona dhe partnerëve të industrisë”.

Barnhardt shton që intervenimet e dizajnuara për të plotësuar objektivat e USAID në Kosovë do të rrisin mundësitë për të rinjtë e të rejtat e Kosovës, duke siguruar që studentët universitar të Kosovës të kenë përvojat kurrikulare dhe të aplikuara, të cilat përkthehen në sukses profesional për ata/ato dhe punëdhënësit e tyre.

“Kjo, nga ana tjetër, do të mbështes mundësitë ekonomike dhe do të forcoj dhe shtoj stabilitetin për një prej demokracive më të reja të botës”, thotë Barnhardt.

“Ky projekt do të rrisë mundësitë për të rinjtë dhe të rejtat e Kosovës, duke siguruar që studentët universitar të Kosovës të kenë përvojat kurrikulare dhe të aplikuara, të cilat përkthehen në sukses profesional për ata/ato dhe punëdhënësit e tyre.” – Cassie Barnhardt, Profesoreshë e Asociuar e Arsimit të Lartë dhe Çështjet e Studentëve në Universitetin e Iowa, Kolegji i Arsimit i Universitetit të Iowa.

Nevoja për përgatitje universitare të cilësisë së lartë në Kosovë është parësore, duke qenë që rinia e Kosovës është resursi më i pasur i Kosovës, me 42% të kombit që është nën moshën 25 vjeçare. Përgjithësisht, Kosova përballlet me vështirësi nga një treg i fuqisë punëtore që vazhdon të jetë i dobët, me një papunësi të rinisë që përgjithësisht sillet tek 30%.

“Lidershipi i UI si partner implementues i USAID, është një hap i rëndësishëm për të siguruar që universitetet publike në SHBA të mbrojnë dhe mbajnë zotimet kombëtare dhe ndërkombëtare,” thotë Daniel L. Clay, Dekan i Kolegjit të Arsimit të UI. “UI është duke ofruar ekspertizë për forcimin e marrëdhënive të cilat mbajnë potencialin të ekzistojnë për një gjeneratë të re të profesorëve, studentëve, dhe liderëve të industrisë. Ne do të lartësojmë marrëdhëniet ekzistuese me sektorin privat në Iowa dhe në Kosovë, të cilat do të sjellin mundësi të përfitimeve reciproke dhe lidhje në të dy vendet. Mundësitë për studentë, profesorë, dhe për sektorin privat do të rriten.”

Qëllimi përfundimtar i këtij projekti është përshtatja e programeve akademike universitare me nevojat e tregut të punës në Kosovë, promovimi i bashkëpunimit mes universiteteve dhe kompanive, dhe përmirësimi i mundësive ekonomike dhe profesionale për të diplomuarit universitar në Kosovë.

Ekspertët e USI do të udhëheqin përpjekjet për të shtuar bashkëpunimin në sektorin bujqësor, duke përfshirë udhëzime në tema si, hulumtimi i aplikuar, ndërveprimi me industrinë, zhvillimi i kurrikulës, metodat mësimore dhe shërbimet për studentë, thotë Curtis Youngs, Profesor i Rregullt nga Universiteti i Shtetit të Iowa dhe Specialist në fushën e Bujqësisë, i cili është duke udhëhequr angazhimin e USI në iniciativën në fjalë.

Armand Krasniqi, rektor i Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka”, një prej universiteteve partnere, thotë, “Ne jemi të ngazëlyer të bashkëpunojmë me studies nga Universiteti i Iowa dhe Universitetit të Shtetit të Iowa për të arritur objektivat thelbësore të forcimit të bashkëpunimit me sektorin privat, duke rritur numrin e stazheve, dhe përmirësimin e mundësive për punësimin e studentëve tanë. Shpeshim mirënjohjen më të sinqertë ndaj USAID dhe kemi besim që përfaqësuesit nga UI dhe USI do të ndajnë praktikat dhe njohuritë e tyre më të mira me stafin dhe studentët tanë. Unë besoj fuqishëm që ky projekt do të ketë një ndikim jashtëzakonisht pozitiv në shoqërinë e Kosovës.”

Kjo iniciativë ndërtohet mbi dekada të bashkëpunimit ndërkombëtar mes Kosovës dhe shtetit të Iowa's. E themeluar më 2013, lidhja “motër-shtet” mes Iowa dhe Kosovës ka krijuar një bazë për partneritete përgjatë fushave të shumta, duke përfshirë ushtrinë, sigurinë/mbrojtjen, arsimin, bujqësinë, tregtinë, rininë/sportin, artet, dhe turizmin.

“Karakteristikat dhe ngjashmëritë mes Iowa dhe Kosovës, si popullsia, traditat rurale dhe bujqësore, dhe potenciali i kapacitetit të dijës, e bëjnë Iowa një partner ideal për t'i ndihmuar Kosovës në zhvillimin e potencialit arsimor, ekonomik, dhe shoqëror”, thotë Russell Ganim, prorektor i asociuar dhe dekan i Programeve Ndërkombëtare të Universitetit të Iowa. “Pas viteve të tëra të thellimit të komunikimit të shoqërisë civile mes Iowa dhe Kosovës, ky aktivitet formalizon marrëdhëniet e shumëfishta, duke sjellur së bashku ekspertizën dhe leadershipin.”

Për një kohë të gjatë, UI ka pasur profesorë nga arsimit, drejtësia, dhe biznesi, të cilët kanë punuar së bashku me universitetet e Kosovës, dhe kjo iniciativë tutje do të përfshij pjesë të tjera të institucionit – Programet Ndërkombëtare, Qendra e UI për Politika Publike, profesorë nga Kolegji i Arteve Liberale dhe Shkencave, si dhe ekspertë të tjera përgjatë Kolegjit të Arsimit, shpjegon tutje Barnhardt.

“Ne jemi duke kapitalizuar nga marrëdhëniet ekzistuese dhe duke rritur të tjera të reja,” thotë Barnhardt. “Prezenca e Konsullatës së Republikës së Kosovës në Des Moines, Iowa ka ndihmuar në thellimin e marrëdhënieve mes kompanive, universiteteve, dhe sektorit civil në Iowa dhe Kosovë, dhe kjo përfshin lidhjet që edhe UI edhe USI kanë.”

Aktiviteti i USAID u bë publik në një ngjarje inaugurimi më 24 Prill në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës në Prishtinë, me pjesëmarrje nga Ambasadori i SHBA-së në Kosovë Jeffrey Hovenier dhe Kryeministri i Kosovës Albin Kurti, së bashku me zyrtarë dhe udhëheqës projektësh nga UI dhe USI. Kjo përfshiu Barnhardt, Dekanin e Kolegjit të UI për Arsim Daniel L. Clay, dhe Russell Ganim, Prorektor i Asociuar i UI dhe Dekan i Programeve Ndërkombëtare.